VENDUM ËSHTË I PLOTFUQISHËM ODEL MAJE DE VNOSMAZIJA IYKATA HALIMELEME / OSJOVNI SUD FERIZAJ I UROSEVAC

04.05 2017

P. nr.397/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Gjyqtari i vetëm gjykues Sahit Krasniqi me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.656-4/17, të dt. 10.02.2017, për veprën penale "vjedhje pyllit "nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPP-së, me dt. 29.03.2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.656-4/16, të dt. 10 shkurt 2017, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit nga i ati nga i ati nga i lindur më ë fsh.

Komuna Ferizaj, me vendbanim të njejtë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datën 30.04.2016, rreth orës 18:20 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, pylltari, dhe zhvillim rural në Ferizaj, në rajonin ekonomiko pyjor Nerodime – Jezercë, në vendin e quajtur "Ngastra 14" me qëllim ka prerë 6 drunjë të llojit ahu me diametër 23-37 cm, lartësi të bonitetit III gjithsejtë në kubatorë prej 2.82 m³, vlera e dëmit të shkaktuar është 431,46 euro të cilat drunjë i ka bajtur me traktor IMT 539,

me të cilën ka kryer veprën penale "vjedhje e pyllit " nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 23, 41, 42, 43, 46, 73 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

GJYKON

Konform nenit 450 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P. nr. 397/17 dt. 29.03.2017

Sekretare Juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues

Adelina Sallahu

Milletin

Sahit Krasniqi

y leeceez

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.